




|   |               |
|---|---------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |               |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |               |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.<br>Nr. i faq.<br>Broj stranica<br>Nr. pages                    | 2-D/DPK<br>02 |
| Nr. Prot.<br>Bi-Prot.<br>Prot No  | 01-2836/14    |
| Data<br>Datum<br>Date   | 11.08.2014    |
| PRISHTINE   |               |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.08.2014, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I.** Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-2181-14 për z. Ilmi Azemi – Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

**I.** Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-2181-14, për Zyrtarin e lartë, z. Ilmi Azemi – Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë dhe njëkohësisht person i autorizuar në disa biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Ilmi Azemi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D/DPK-01-2544/14), pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Azemi është deklaruar do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuar për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Azemi, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar shkresat zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi bizneset" (DPK-03-2772-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, "Korabi - Company" sh.p.k., z. Azemi për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik, ashtu siç e kërkon ligji, ka heq dorë nga te qenurit personit të autorizuar i biznesit privat. Tani, z. Azemi, ushtron vetëm funksionin e Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrta i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zurtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zurtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit



*[Handwritten signature]*